

SHTOJCA 3

Formulari i kërkesës për vazhdimin e lejes mjedisore

Emri i kompanisë	“ Agi - Dani” SH.P.K.
Lloji i veprimtarisë	Bazë për prodhimin e betonit
Vendi ku zhvillon Veprimtarinë	Strazhë, Komuna e Novobërdës
Emri, mbiemri dhe nënshkrimi i personit përgjegjës i kompanisë	Halit Bajraliu
Adresa	34, Rexhep Mala, Gjilan, Kosova
Telefoni, fax, e-mail	+383 44 575 736, agi-danishpk@hotmail.com
Emri dhe mbiemri i personit kontaktues përgjegjës për mjedis	Rexhep Veseli, Përfaqësues i Autorizuar
Adresa	34, Rexhep Mala, Gjilan, Kosova
Telefoni, fax, e-mail	-383 44 132 335
Numri i vendimit të Lejes Mjedisore Paraprake	– Leje Mjedisore: 3805-2/18, 26.02.2019,
Përshkrimi i dokumentacionit bashkangjitur kërkesës, përfshirë numrin e protokollit të dokumentit, datën e lëshimit dhe skadimit	– Certifikata e regjistrimit të Biznesit me nr. Unik Identifikues: 810272526, 04/10/2006 – Formulari i plotësuar sipas kushteve në shtojcën 3, – Pëlqimi Mjedisor: 6058-8/17, 26.12.2017, – Leje Mjedisore: 3805-2/18, 26.02.2019, – Leje Ujore Shfrytëzim: 2471-2/20, 04.10.2021, – Leje Ujore Shfrytëzim: 2470-2/20, 04.10.2021, – Licenca nga KPMM: 973/KPMM/2026
Fatura e pagesës së tarifës për vazhdimin e Lejes Mjedisore	Po, Vlera investive 178,000.00 €
Pesë(1) kopje fizike dhe një (1) elektronike (CD)	Po

Shtojca 2


Aplikacion për dhënien e lejes mjedisore

APLIKACION PËR DHËNJEN E LEJËS MJEDISORE		
1. TE DHËNAT E PËRGJITHSHME		
1.1. Të dhënat për Operatorin		
1.1.1.	Emri i subjektit	“Agi - Dani” SH.P.K. - Bazë për prodhimin e betonit
	Vendi	Strazhë, komuna e Novobërdës
	Adresa	Rr.Rexhep Mala 34
	Nr. i tel./fax	+383 44 575 736
	E-mail	agi-danishpk@hotmail.com
1.1.2.	Numri i regjistrimit të biznesit, data e regjistrimit	810272526, 04/10/2006
1.1.3.	Personi Përgjegjës i kompanisë	Halit Bajraliu
	Nr. i tel./fax	-383 44 132 335
	E-mail	agi-danishpk@hotmail.com
1.2. Të dhënat për kompaninë		
1.2.1.	Emri i kompanisë	“Agi - Dani” SH.P.K. - Bazë për prodhimin e betonit
1.2.2.	Adresa e lokacionit të impiantit	Strazhë, komuna e Novobërdës

2. TË DHËNAT PËR LOKACIONIN E IMPIANTIT


2.1.	Të dhënat për lokacionin ku zhvillohet veprimtaria sipas hartës së bashkangjitur
------	---

Baza për prodhimin e bazës së betonit shtrihet në zonën kadastrale Strazhë, Komuna e Novobërdës, e cila është afër këtyre zonave kadastrale: Koretishtë dhe Stanishor.



2.2.	Numri kadastral i parcelēs
------	-------------------------------

Objekti i Bazës së prodhimit të betonit me të gjitha objektet përcjellëse është vendosur në ngastrat kadastrale me nr. P-72403058-04091-0, ZK. Strazhë në Komunën e Novobërdës.



2.3.	Përshkrimi i lokacionit të gjitha objektet dhe aktivitetet e tyre në atë zonë
------	---

Në afërsi të Bazës së Betonit gjendet një seperacion me distancë 555.67m




2.4.	Të dhënat lidhur me florën dhe fauna në atë lokacion	Në territorin e lokacionit për pos shtazëve dhe shpezëve shtëpiake që i kultivojnë fshatarët e fshatrave në rrethinë të lokacioneve, janë prezentë edhe shtazët e egra si që janë: dhelpra, ujku, lepuri, derri i egër etj., jetojnë edhe gjitarët, zvarranikët, brejtësit, insektet e ndryshme, etj. Shpezët të cilët ekzistojnë në këto lokacione dhe rrethinë janë këto bilbilat, thëllëza e fushës, sorrat, shqiponja, harabeli etj. Gjendja e tanishme e ekuilibrit biologjik-ekologjik të këtyre lokaliteteve ka kushtet të përshtatshme për zhvillimin e saj i cili do të ishte në rritjen e sipërfaqeve me pyje të llojeve të ndryshme të drunjve, rritjen e gjendjes ekzistuese të kafshëve dhe shpezëve dhe begatimin e tyre, kjo vlen edhe për llojet të ndryshme të shpezëve dhe egërsirave të cilat i ka ky territor.
2.5.	Të dhënat mbi zonat e veçanta të mbrojtura	Në afërsi të bazës për prodhimin e betonit nuk ka zona të veçanta të mbrojtura. Në një distancë prej 932.78 m ndodhet Kisha Ortodokse Serbe e Shën Zhorxhit. 

3. PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE MBI VEPRIMTARINË

3.1. Përshkrim i aktivitetit për të cilën kërkohet Leja Mjedisore

3.1.1. Skema e procesit teknologjik



3.1.2. Përshkrim i pajisjeve dhe fazat e procesit teknologjik

Procesi Teknologjik i Prodhimit të Betonit përbëhet prej këtyre objekteve dhe pajisjeve:

- Objekti i administratës.
- Dy linja të bazës së betonit Linja 1 dhe 2
- Linja e pare (L1) e prodhimit të betonit ka 2 silos , S1-100t dhe S2-100t
- Linja e dyte (L2) e prodhimit te Betonit: L2, S1- 125 t dhe S2-125t
- Pajimet për prodhimin e betonit
- mikseri kapaciteti 1 m3, kapaciteti i prodhimit të betonit 50 m3/orë,
- Kompresori për furnizim me ajër,
- Dozatori, me katër lloje fraksionesh të agregatit: +0-4mm; +4-8mm; +8+16mm; +16-22mm ose +16- 31,5mm.
- Peshojat automatike për matjen e agregatit dhe çimentos.
- Mekanizmi (ena) për furnizim me agregat.
- Ormani me tabelën komanduese.
- Rezervari i ujit me kapacitet prej 5000 litra
- Pompa me sistemin e furnizimit me ujë,
- Deponia -platoja për fraksionet e agregatit.

- Shtyllat dhe platoja prej betoni në lartësi prej 3.80m ku janë të vendosur mikseri dhe siloset
- Gjeneratori për furnizim me energji elektrike.



Betoniera është adekuate për prodhimin e betonit dhe i përgjigjet ISO standardeve. Baza e betonit me pajimet përcjellëse për realizimin procesit teknologjik për prodhimin e llojeve të betoneve. Koncepti prodhues i bazës së betonit, posedon teknologji dhe pajime me të cilat do të mundë të prodhoj të gjitha llojet e betonit të cilësisë së lartë. Materialet e nevojshme për prodhimin e betonit janë: çimentoja, fraksionet e gurit /rërës, uji dhe aditivët. Fraksionet e gurit/rërës janë: +0- 4mm, +4-8mm, +8-16mm dhe +16-31.5 mm. Procesi i prodhimit të betonit është proces i mbyllur, i tërë procesi kontrollohet dhe menaxhohet në mënyrë bashkëkohore. Prodhimet e betonit paraqet konglomerat që do të përfitohet me përzierjen e çimentos, fraksioneve të rërës/gurit dhe ujit. Me programin e prodhimit parashihet prodhimi i këtyre llojeve të betoneve: Betonet klasike Betoniet klasike që punohen pa pompa BK1 prodhohen me katër fraksione te agregatit dhe dallohen sipas fortësisë apo kualitetit te tyre

1. BK11- Betoni klasik i markës MB15 (klasa C12/15)
2. BK12- Betoni klasik i markës MB20 (klasa C16/20)
3. BK13- Betoni klasik i markës MB25 (klasa C12/25)
4. BK14- Betoni klasik i markës MB30 (klasa C25/30)
5. BK15- Betoni klasik i markës MB35 (klasa C30/37)

6. BK16- Betoni klasik i markës MB40 (klasa C35/45)

Betonet që punohen me pompë kanë shenjë „BP1” prodhohen në katër fraksione të agregatit dhe dallohen sipas fortësisë apo kualitetit të tyre

1. BP11- Betoni pompe i markës MB20 (klasa C16/20)
2. BP12- Betoni pompe i markës MB25 (klasa C20/25)
3. BP13- Betoni pompe i markës MB30 (klasa C25/30)
4. BP14- Betoni pompe i markës MB35 (klasa C30/37)

Betone speciale beton që i reziston ujit 0 -1 ujit 0 - 31.5 Beton MB20, Beton MB25, Beton MB30, Beton MB35. Përpos këtyre llojeve të betoneve mund të prodhohen edhe lloje të veçanta të betoneve: për ndërtim të rrugëve, urave, tunele, për konstruksione nën ujë etj. Komponentët në procesin e prodhimit të betonit Çimentoja - paraqet komponentin lidhës të betonit. Sipas teknologjisë për prodhimin e betonit në betonier përdoret çimentoja Portland. Në raste të veçanta varësisht prej llojit të prodhimit të betoneve, përdoren çimentot speciale. Cilësia e çimentos përcaktohet në bazë të aftësisë lidhëse të shprehur nëpërmjet fortësisë. Dallojmë disa lloje të fortësisë: 200, 320, 500, 600 dhe 800 kp/cm². Çimentoja Portland nuk duhet të ketë aftësi në fortësi më të vogël se 320 kp/cm². Sasia për prodhimin e betonit, përkatësisht harxhimi specifik i çimentos, është 200-400 kg për 1m³.

Agregati guri /ose rëra, këtë material (fraksionet e gurit gëlqeror) për arsye të cilësisë së lart të dëshmuar furnizohet nga gurthyesit në Reqak dhe rajon. Agregati duhet të përmbush kushtet e parapara në pikëpamje të cilësisë dhe granulimit. Rëra cilësore duhet të jetë e pastër dhe me përbërje të lartë të kuarcit. Agregati duhet të jetë pa asnjë shtesë të cilat reagojnë me ujin dhe shkaktojnë shkapërderdhje, kloridet, sulfatet dhe komponimet tjera kimike që dëmtojnë vetit fizike dhe mekanike të betonit. Materiet organike dhe humusi pengojnë ngurtësimin e çimentos në beton. Preferohet që raporti i agregatit në beton të jetë 1:2-1:7, varësisht prej llojit të betonit që kërkohet të prodhohet.

Uji - është komponent i rëndësishëm për lidhje gjatë prodhimit të betonit. Çështjen e ujit pronari e ka zgjidhur më anë të pusit, të cilin e ka shpuar me anë të pompave, e mbushë rezervuarin i cili nevojitet për mbajtjen e ujit rezervë për nevoja të betonierës, pusi dhe rezervuari gjinden në afërsi të betonierës dhe në pronësi të kompanisë.

Në procesin e prodhimit të betonit përdoret vetëm uji i pastër, ujë që nuk përmban materie organike që formohen nga bimët e kalbura. Harxhimi specifik i ujit në procesin teknologjik për prodhimin e betonit varet nga lloji i betonit që dëshirojmë të prodhojmë. Në vijim do të i pet përqindja e ujit në beton në varësi nga lloji i betonit:

- për beton të lëngshëm 6-8%
- për beton plastik 7- 9%
- për beton të fortë plastik 8-10%.

Si që kemi cekur në pasuset e më sipërme në këtë betonier mund të prodhojmë beton të kualiteteve të ndryshme duke u bazuar ne destinimin e tij dhe atë sipas nevojës dhe kërkesave.

Përshkrimi i procesit teknologjik

Procesi teknologjik i vijës së parë dhe të dytë për prodhimin e betonit:

Fraksionet fr.0÷32mm me ngarkues, ngarkohen prej deponie në tre bateritë (bunkerët) e fraksioneve nr.1 linja 1 dhe tre bateri linja 2 (sipas nevojës, varësisht prej kërkesave te tregut). Prej pultit të komandimit, fraksionet lëshohen sipas nevoje në peshore Nr.2 në shiritin transportues nr.3 që i ka këto karakteristika: L=6.8m B=600mm me n=3rule P=3.5kw.

Edhe shiriti transportues nr.3 është në peshore. Kur të bëhet ngarkesa në peshore, për një cikël përzierje në auto mikser, atëherë transportohen në shiritin kryesor nr.4 me këto karakteristika: L-9.4m n=2rule, a=28.70 B=600mm i cili i transporton fraksionet në Auto kamion mikser. Prej pultit të komandimit dërgohet sasia e çimentos nga siloset nr.5 me gyp kërmill në enën peshore Nr.6. Kjo enë furnizohet me çimento për një përzierje të një m³ beton. Sasia e çimentos nga peshoja nr.6 përcillet me gyp (paralel me shiritin nr.4)ë formë kërmilli (brenda) në krye të shiritit kryesor nr.4 dhe zbrazen në auto kamion mikser. Tani i jepet sasia e nevojshme e ujit. Kur të përfundon cikli vazhdon cikli tjetër, deri sa të bëhet ngarkesa e nevojshme në auto kamion. Auto kamioni mikser vendosët në hinkën dhe fillon rrotullimi i tij deri të ngarkohet, dhe vazhdon me rrotullim deri në zbrazjen e tij në vendin e dedikuar. Peshorja nën bunkerët e fraksioneve i ka këto ngarkesa: sasinë e fraksioneve, shiritin transportues dhe peshoren e çimentos. Sasia e çimentos në beton sillet rreth 330-370kg/m³ kjo varet prej kërkesës që duhet ta ketë marka e betonit. Pastaj, përzierjes i epet sasia e

nevojshme e ujit rreth: 140-180 litra/m³ beton. Sipas nevojë i jepet sasi e nevojshme e aditivit (për anti lagështi), rreth: 1-1.5 litra në kubik. Pas ngarkesës, lëshohet në auto mikser për transport në vend të dedikuar. Çimentoja në peshore nr.6 vjen nga silosi nr.5 me anën e gypave spiral (kërmill). Çimentoja nga siloset përcillet nëpër mes gypit me kërmill, të cilin e rrotullon elektromotori me fuqi: P=4kw Sasia e çimentos në dy rezervuar (siloset) është: 30+27=57t Sasia e ujit për një përzierje sillet rreth: 140-180 në metër kub beton. Sasia e ujit varet edhe prej lagështisë në fraksione. Nga kompjuteri në pultin e komandimit, jepen sasitë e nevojshme të fraksioneve, çimentos, ujit, aditivit dhe tërë procesi (cikluesi) ecën në mënyrë automatike. Nuk ka nevojë të intervenohet në procesin e punës. Vlen të theksohet se në këtë impiant, nuk ka mikser për përzierjen e fraksioneve me cimet dhe uji, por përzierja bëhet në auto kamion mikser. Pas çdo pune të prodhimit të Betonit duhet të bëhet pastrimi detal i impiantit. Prodhimtaria orare e betonit është: Qh=60m³ /h Prodhimtaria ditore: Qd=600m³ /dit. Sipas nevojave në treg, nga një herë, prodhimtaria e betonit do të zgjas më tepër se një turn. Sitat Para se të lëshohen pajimet për realizimin e procesit. teknologjik për prodhimin e betonit, duhet të kryhen këto veprime;

- Duhet të sigurohet sasia e mjaftueshme e agregatit në silose.
- Duhet të sigurohet sasia e mjaftueshme e çimentos dhe duhet hapur vetëm ventilin e silosit nga i cili dëshirojmë të marrim çimento.
- Duhet të sigurohet sasia e nevojshme e ujit.
- Duhet caktuar recepturën për kualitetin e betonit të cilin dëshirojmë të e prodhojmë
- Të caktohet zgjatja e kohës së ciklit të prodhimit të betonit duke u bazuar në recepturën e caktuar.

Pajimet mund të funksionojnë në mënyrë automatike me dozim të programuar dhe në mënyrë manuale. Menaxhimi i procesit teknologjik i prodhimit të betonit, kryhet nga pulti komandues i automatizuar i vendosur në dhomën (hapësirën) të caktuar për të. Modulet hyrëse drejtpërdrejt pranojnë sinjalet nga dozatorët dhe peshojat, nëpërmjet sondave për të gjithë komponentët e procesit të prodhimit. Modulet digjitale dalëse shërbejnë për menaxhimin e ventileve elektromagnetikë, motorëve si dhe

		llampave sinjalizuese. Menaxhimi i ter procesit të prodhimit bëhet edhe përmes disa monitorëve të vendosur në panelin e komandimit, përmes këtij paneli operatorit i mundësohet të bëj mbikëqyrjen e ter procesit, dhe recepturat për prodhimin e betonit, me këtë mundësohet matja lehtë e komponentëve të agregatit, bitumenit dhe komponentëve tjera shtesë. Për të arritur cilësinë e duhur të betonit bëhet sitja e çimentos me sita standarde dhe përcaktohet koha e lidhjes se sajë. (Koha e lidhjes se çimentos paraqet kohën nga momenti i përzierjes së çimentos me ujë gjer në momentin e fillimit të hidratimit të sajë dhe arritjes së fortësisë përkatëse). Përpos komponentëve të lartcekura për të arritur veçori specifike të betonit, duhet shtuar Aditivët. Në sezonin e dimrit dhe për konstruksione të veçanta shtohen aditivë të cilët e shpejtojnë kohën e ngurtësimit. Aditivi kryesisht shtohet me ujë, ose drejtë për drejt në mikser. Dozimi i aditivit kryesisht shtohet 2 - 4% të masës së çimentos. Për realizimin e procesit teknologjik për prodhimin e betonit, me energji elektrike furnizohet nga rrjeti elektrik nëpërmjet trafos të ndërtuar nga kompania, gjithashtu në mungesë të energjisë elektrike kompania posedon gjeneratorin për realizimin e procesit teknologjik. Përpos pajisjeve të lartë cekura për realizimin e procesit teknologjik për prodhimin e betonit dhe për bartjen e tij gjer të hargjuesi (konsumatori), kompania disponon edhe këtë mekanizëm: auto mikserë, auto cisternë për bartjen e çimentos, një pompë të betonit (90m³ /orë), tre kamionë (3x20 m³) për bartjen e fraksioneve të agregatit dhe dy lopata ngarkuese.
3.1.3.	Numri i orëve të punës dhe ditëve të punës gjatë javës për kryerjen e aktiviteteve	Aktiviteti zhvillohet 6 ditë në javë, nga 8 orë në ditë (gjithsej 48 orë/javë), me orar pune nga ora 08:00 deri në 16:00.
3.1.4.	Kapaciteti i projektuar dhe kapaciteti i realizuar, ditor, mujor, vjetor	Kapaciteti i projektuar 90 m ³ /h
3.1.5.	Të dhënat për shfrytëzimin e lëndës	Komponentët hyrëse në procesin e prodhimit të betonit janë: – Energjia elektrike,

	së parë dhe lëndëve ndihmëse	– Nafta – Guri gëlqeror – Çimentoja Karburantet si lëndë djegëse nafta shërbenë për furnizimin e automjeteve transportuese dhe ngarkuese. Energjia elektrike shërben për ndriçim dhe funksionim të pajisjeve si dhe për nxehje. Furnizimi me energji elektrike bëhet nga rrjeti shpërndarës i energjisë elektrike, nëpër mes trafostacionit që është pronë e kompanisë.  Uji shfrytëzohet për qëllime sanitare për prodhimin e betonit, spërkatjen e sipërfaqes operationale, ujitjen e sipërfaqeve të gjelbëruara. Furnizimi me ujë bëhet nga pusi i cili është nxjerr me shpim të thellë nga pronari i Kompanisë.
3.1.6.	Lista e rezervuarve dhe kapaciteti i tyre	Kompania nuk posedon rezervuar të naftës.
3.1.7.	Lista e legjislacionit në fuqi	<u>Ligjet:</u> Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025 Ligji për Mbeturina Nr. 04/L-060 Ligji për Planifikim Hapësinor Nr. 04/L-174 Ligji për Tokën Bujqësore Nr. 02/L- 26 Ligji për Mbrojtjen nga Zhurma Nr. 02/L- 102 Ligji për Ujërat e Kosovës Nr. 04/L-147 Ligji për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja Nr. 08/L-025

		Ligji për Mbrojtjen e Natyrës Nr.03/L-233 <u>Udhëzimet Administrative</u> Udhëzimi administrativ Nr.04/2022 për Lejen Mjedisore; Udhëzim Administrativ (mmph) nr. 01/2025 për ndryshimin dhe plotësimin e udhëzimit administrativ (mmph) nr. 04/2022 për leje mjedisore Udhëzimit Administrativ (QRK) Nr. 07/2021 për rregullat dhe dhe normat e shkarkimeve ne ajër nga burimet e palëvizshme të ndotjes; Udhëzimi administrativ Nr. 01/2017 për cilësinë e karburanteve të lëngëta të naftës; Udhëzimi administrativ- nr. 13/2013 Për katalogun Shtetëror të mbeturinave
--	--	--

3.2 Menaxhimi i Mbrojtjes së Mjedisit		
3.2.1	Sistemi	Bazë për prodhimin e betonit në Strazhë, Novobërdë, është e përkushtuar më të gjitha funksionet e sajë organizative në përmirësimet e vazhdueshme që të përmbushë të gjitha detyrimet ligjore për të pasur një Mjedis të pastër dhe të qëndrueshëm. Sistemet e Menaxhimit Mjedisor bazuar në IOS 14001 japin mundësinë e identifikimit, vlerësimit dhe menaxhimit të aspekteve mjedisore të një organizmate me synim: – Respektimin e legjislacionit vendor – Parandalimin e dëmtimit të Mjedisit – Përmirësimin e vazhdueshëm të Mjedisit.
3.2.2	Raportimi	Kompania raporton në MMPH, sipas kushteve të lejes mjedisore.

4. AJRI DHE NDRYSHIMET KLIMATIKE


4.1.	Pikat e burimit të emisioneve e materieve ndotëse	Nga ky aktivitet mund të paraqiten emisione në ajër, kryesisht në formë pluhuri, por në kufij të lejuar dhe të kontrollueshëm. Pluhuri krijohet kryesisht gjatë mbushjes së bunkerëve, si dhe nga lëvizja e makinerive në sipërfaqet manipuluese. Po ashtu, në rast të përdorimit të makinerive më të vjetra, mund të ndodhë lirimi i gazrave të djegies, të cilat mund të ndikojnë në cilësinë e ajrit në nivel lokal. Ndikime minimale në ajër mund të shfaqen edhe gjatë sjelljes së materialeve ndërtimore me kamionë, si dhe gjatë lëvizjes së mikserëve, mirëpo këto ndikime janë të karakterit të përkohshëm dhe mund të kontrollohen lehtë me masa të zakonshme operative.
4.2.	Ndikimi i materieve ndotëse në cilësinë e ajrit	Ndikimet në ajër gjatë realizimit të procesit teknologjik ndodhin nga: – Pluhurat të cilët lirohen nga rrugët jo të asfaltuara dhe sipërfaqet operacionale që ndodhën në afërsi të eksploatimit – Gazrat të cilat lirohen nga automjetet e transportit dhe ngarkimit.
4.3.	Burimet difuzive të emisioneve të materieve ndotëse	Burimet difuzive të emisioneve të materieve ndotëse janë ato burime që nuk dalin nga një pikë e vetme (si oxhaku), por shpërndahen në sipërfaqe dhe gjatë lëvizjeve/operimeve, të cilat janë: – Sipërfaqet manipuluese dhe rrugët e brendshme - Pluhur i ngritur nga lëvizja e kamionëve, mikserëve dhe ngarkuesve. – Bunkerat e agregateve në ambient të hapur - Pluhur nga era dhe nga ngarkim shkarkimet e shpeshta. – Shkarkimi dhe ngarkimi i materialeve në bunkerë/hinka – Zona e ngarkimit të produktit në mjete transportuese - Pluhur gjatë ngarkimit dhe nivelimit të materialit. – Qarkullimi dhe punët operative të makinerive - Emisione të shpërndara të gazrave të djegies nga motorët
4.4.	Pajisjet për trajtimin e gazrave shkarkuese	Nuk ka vendosur pajisjet për trajtimin e gazrave shkarkuese por ajo e bënë kontrollimin e rregullt teknik të makinave që konsumojnë lëndë djegëse.
4.5.	Pajisjet për de-pluhurim	Kompania posedon sistemin e depluhurisë, filtrat me thasë.
4.6.	Monitorimi i emisioneve	Monitorimi i emisioneve bëhet në ajër dhe ujë.

4.7.	Monitorimi i Emisioneve /cilësisë së ajrit	Sipas kushteve të dala nga leja mjedisore, bëhet monitorimi i emisioneve të ajrit dhe raportohen në MMPH.
4.8.	Raportimet	Raportimet bëhen në MMPH sipas kushteve të lejes mjedisore.
4.9.	Masat për zvogëlimin e ndotjes së ajrit	Për të parandaluar dhe zvogëluar ndikimet negative në ajër, kompania ka ndërmarrë këto masa: Pluhuri që lirohet gjatë procesit teknologjik të prodhimit të betonit kontrollohet dhe zvogëlohet deri në kufijtë e lejuar, në mënyrë që të mos shkaktojë ndikime të theksuara në mjedis. Për zvogëlimin e emisionit të pluhurit, kompania ka të instaluar sistem të filtrave me thasë në siloet që përdoren për deponimin e çimentos. Të gjithë gypat që përdoren për mbushjen e siloseve me çimento, si dhe gypat që furnizojnë mikserin me çimento, kontrollohen rregullisht, ndërsa pjesët lidhëse të tyre mbyllen hermetikisht me elemente adekuate. Thasët e filtrave kontrollohen në mënyrë të vazhdueshme dhe, në rast dëmtimi, zëvendësohen menjëherë. Kryhet kontroll i rregullt teknik i automjeteve transportuese që përdorin lëndë djegëse të lëngëta, me qëllim që emisionet e gazrave të jenë brenda standardeve të lejuara. Po ashtu, bëhet spërkatja me ujë e sipërfaqeve operacionale, larja e platos ku janë të vendosura pajisjet për prodhimin e betonit, si dhe spërkatja me ujë e grumbujve të agregatit, sidomos gjatë motit me erëra dhe temperatura të larta.
4.10.	Masat për zvogëlimin e ndikimeve në ndryshimet klimatike	Masat për zvogëlimin e ndikimeve në ndryshimet klimatike (ulja e emetimeve të gazeve serrë) për bazën e betonit mund të përfshijnë: – Mirëmbajtje e rregullt e makinerive dhe automjeteve, – Planifikim i rrugëve dhe orareve të furnizimit për të reduktuar kilometrat bosh dhe pritjet e panevojshme. – Ndalimi i punës së motorëve në vend gjatë pritjeve dhe ngarkim shkarkimeve, përveç rasteve teknike të domosdoshme. – Menaxhimi i materialeve dhe reduktimi i humbjeve: dozimi i saktë, shmangia e derdhjeve dhe rikthimi i materialit të pastër në proces kur është teknikisht e mundur. – Trajnim i personelit për ngarje ekonomike, operim racional të pajisjeve dhe zbatim të masave për ulje të konsumit të karburantit.

5. UJI

5.1.	Të dhënat për shfrytëzimin e ujit	Uji sigurohet nga rezervuari i cili mbushet nga pus i hapur brenda lokacionit të bazës për prodhimin e betonit, i cili shfrytëzohet për nevojat e procesit dhe të operimit.
5.2.	Të dhënat për shkarkimin e ujërave, shkarkimet e ujerave sipërfaqësorë apo në rrjetin e kanalizimit	Nuk kryhet shkarkim i ujërave në ujërat sipërfaqësorë dhe as në rrjetin e kanalizimit, pasi në lokacion është i instaluar sistem për rikthimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura në procesin teknologjik. 
5.3.	Ndikimet në ujë	Ndikimet në ujë nga aktiviteti i bazës për prodhimin e betonit janë kryesisht të kufizuara dhe lidhen më shumë me rreziqe aksidentale sesa me shkarkime të rregullta: – Rrjedhje aksidentale të vajrave dhe karburanteve nga makineritë dhe automjetet, që mund të depërtojnë në tokë dhe potencialisht të ndikojnë ujërat nëntokësore. – Ujërat atmosferike në sipërfaqet manipuluese, të cilat mund të marrin sedimente dhe gjurmë ndotësish, nëse nuk menaxhohet drenazhimi

		dhe pastrimi i rregullt. – Procesi teknologjik nuk shkakton shkarkime në ujërat sipërfaqësore apo në kanalizim, pasi uji riciklohet në sistem të mbyllur.
5.4.	Emisionet e ujërave të ndotura - treguesi i emisioneve kryesor	Nuk gjenerohen ndotje serioze të ujërave sipërfaqësore, as të ujërave nëntokësore, pasi ndërrimi i vajrave dhe shërbimet e mirëmbajtjes nuk kryhen brenda kompleksit, por në autoservis. Për rrjedhojë, nga ky aktivitet nuk parashihen emisione të ujërave të ndotura.
5.5	Trajtimi i ujërave të ndotura	Në lokacion është i instaluar pus sedimentues me kaskada për fundërrimin e grimcave që vijnë nga shpëlarja e automikserëve, ndërsa uji i trajtuar rikthehet dhe ripërdoret në procesin teknologjik.
5.6.	Kontrolli dhe matjet	Kontrolli dhe matjet kryhen nga kompani të kontraktuara për këtë qëllim, ndërsa rezultatet raportohen në MMPH.
5.7.	Raportimi	Raportimi në MMPP bëhet sipas dinamikës së përcaktuar në kushtet e lejes mjedisore.
5.8.	Leje Ujore për shfrytëzim të ujit	Kompania posedon leje ujore për shfrytëzim nga ARPL.
5.9.	Leje Ujore për shkarkimin e ujërave	Kompania posedon Leje ujqorë shkarkimin e ujërave.
5.10.	Masat për zvogëlimin e ndotjes së ujërave	Për të parandaluar e zvogëluar sasinë e ndikimeve negative në ujë të cilat i kemi cek më lartë janë ndërmarr këto masa: Në lokalitetin e betonierës është bërë sistemi për grumbullimin dhe bartjen e ujërave të ndotura të krijuara nga procesi i prodhimit, nga larja e automjeteve transportuese, automikserëve për transportimin e betonit dhe automjeteve tjera të rënda, ujërave nga të reshurat atmosferike. Është rregulluar sistemin gypor për bartjen e ujërave të ndotura të cilat duhet të dërgohen për trajtim në puse sedimentuese për pastrimin e ujërave të ndotur me grimca të ngurta. Kolektorët janë rregulluar në pozicionet e caktuara me qëllim që e tërë sasia e ujërave industriale dhe e të reshurave atmosferike nga platot dhe nga tëra sipërfaqet funksionale të grumbullohen dhe të orientohen në pusët sedimentuese e pastaj në separator.



Janë ndërtuar tre puse sedimentuese në atë mënyrë që të mundë të sedimentohen grimcat e ngurta, e pas trajtimit të ujërave në puset sedimentuese, uji orientohet për trajtim të mëtutjeshëm në seperatorin për pastrimin e ujërave të ndotur nga derivatet dhe vajrat të cilat kanë rrjedh në sipërfaqet operacionale, nga pajimet e punës, e pasandaj ujërat e trajtuara nga seperatori lirohen në recipient. Seperatorin është rregulluar në atë mënyrë që të mundë të kontrollohet rregullisht uji i cili pastrohet dhe të merren mostrat e ujit i cili pastrohet. Ujërat e zeza së pari trajtohen në gropën septike, e cila është ndërtuar ne varshmëri me numrin e punëtorëve, dhe pas trajtimit lëshohen ne sedimentues. Gropa septike pastrohet nga kompanitë e licencuara.



6. ZHURMA		
6.1.	Burimet	Burimet e zhurmës në bazën e prodhimit të betonit janë kryesisht: – Makineritë e punës (ngarkues, eskavator, buldozer, etj.). – Impianti i përzierjes, veçanërisht mikseri dhe sistemi i dozimit/transportuesit. – Lëvizja e automjeteve dhe kamionëve brenda lokacionit – Ngarkim shkarkimi i agregateve dhe materialeve – Pajisjet ndihmëse dhe punët e mirëmbajtjes Zhurmat krijohet gjatë operimit të bazës së betonit janë brenda kufijve të lejuar dhe, për shkak të natyrës së aktivitetit dhe orarit të punës, nuk parashihen të shkaktjnë ndikime negative të rëndësishme në mjedisin përreth.
6.2.	Kontrolli dhe matjet	Kontrolli dhe matjet kryhen nga kompani të kontraktuara për këtë qëllim, ndërsa rezultatet raportohen në MMPH.
6.3.	Raportimet	Raportimet bëhen sipas dinamikës së përshkruar në kushtet e lejes mjedisore.

7. TOKA		
7.1.	Ndikimet në tokë	Gjatë operimit të bazës për prodhimin e betonit, ndikimet në tokë parashihen të jenë të kufizuara dhe kryesisht lokale. Si pasojë e qarkullimit të shpeshtë të kamionëve dhe makinerive në zonat manipuluese, mund të ndodhë ngjeshje e tokës dhe degradim i lehtë i sipërfaqes. Ndotja e tokës mund të paraqitet vetëm në raste aksidentale, për shkak të rrjedhjeve të vajrave ose karburanteve nga pajisjet dhe automjetet. Po ashtu, depozitimi i pluhurit dhe materialeve të imëta nga agregatet mund të shkaktojë ndotje sipërfaqësore të lehtë, veçanërisht gjatë periudhave të thata. Në tërësi, këto ndikime konsiderohen të menaxhueshme dhe mund të minimizohen me mirëmbajtje të rregullt të makinerive, organizim të kontrolluar të operimeve dhe pastrim periodik të sipërfaqeve të lokacionit.
7.2.	Masat për zvogëlimin e ndikimeve në tokë	Për parandalimin dhe zvogëlimin e ndikimeve negative në tokë, kompania ka ndërmarrë dhe zbaton këto masa: – Mirëmbajtje e rregullt e stabilimenteve dhe pajisjeve prodhuese, përfshirë filtrat e silosëve dhe të gjithë gypat/nyjet lidhëse, me qëllim të parandalimit të rrjedhjeve dhe shpërndarjes së materialeve në tokë. – Kontroll teknik periodik i makinerive dhe automjeteve, si dhe ndërprerje e menjëhershme e punës në rast të rrjedhjeve të vajrave, karburanteve ose lubrifikantëve. – Betonim i sipërfaqeve operacionale dhe i zonave të ndjeshme (zona e pajimeve, gjeneratori), për të parandaluar depërtimin e ndotësve në tokë. – Ndërrim i vajrave dhe mirëmbajtje vetëm në autoservisa, – Pastrim dhe mirëmbajtje periodike e pllato manipuluese dhe rrugëve të brendshme, për të reduktuar depozitimet e pluhurit dhe materialeve të imëta. – Menaxhim i rregullt i mbeturinave: grumbullim dhe magazinim në vende të përcaktuara, dhe dorëzim te operatorë të licencuar. – Asfaltim/betonim i qasjes dhe rrugëve kryesore brenda lokacionit, për të ulur degradimin e sipërfaqes dhe përhapjen e materialeve në tokë. – Gjelbërim i sipërfaqeve jo-funksionale dhe ruajtje e rregullt e tyre, për të stabilizuar tokën dhe për të reduktuar erozionin dhe pluhurin.

7.3.	Përshkrimi i rehabilitimit të zonës pas përfundimit të aktivitetit	Masat Rehabilituese pas Përfundimit të Aktivitetit Prodhues Objektivat e Rikultivimit Pas përfundimit të jetë gjatësisë së bazës për prodhimin e betonit kjo varet nga vjetërsia e pajimeve dhe nga pronari se a do të vazhdoj me këtë projekt me blerjen e pajimeve të reja apo do të e përfundoj aktivitetin e prodhimit të betonit. Duke marrë parasysh lokacionin i cili gjendet në zonën industriale si opsion tjetër që pronari të filloj me biznes tjetër prodhues Pas afatit të përfundimit të aktivitetit prodhues, pajimet e betonierës duhet të çmontohen dhe në bazë të leverdis së kompanisë të shitën si material i vjetruar. Bazamentet si dhe platot nga betoni duhet të shkatërrohen, imtësohen dhe të dërgohen në deponi të qytetit. Nga proceset teknologjike të prodhimit të betonit do të krijohen substrate që i takojnë kategorisë së tokave të dëmtuara d.m.th. substrate të pa përshtatshme (sterile) për rikultivim. Substratet me përmbajtjes të gurit gëlqeror, rërës, zhavorri dhe betoni, etj. që pa tjetër duhet të largohen dhe bëhet zëvendësimi, me një shtresë të humusit prej 0,5m trashësi të analizuar nga aspekti agrokimik, pastaj duhet të bëhet ngjeshja e e kësaj shtrese të humusit (dheut) me qëllim që të jetë shtresa ma kompakte. ashtu qe të krijohet një substrat produktiv i përshtatshëm për rikultivim. Rikultivimi i këtyre sipërfaqeve të dëmtuara përfshin rivitalizimin në tërësi të hapësirave të dëmtuara nga realizimi i projektit. Zgjedhja e modelit të rikultivimit varet nga: Qëllimi i rekultivimit i cili nënkupton që pas përfundimit të punëve në procesin teknologjik, sipërfaqeve të degraduara, prapë tu kthehet funksioni i saj primar (prodhimi i biomasës), dhe kështu zvogëlohet ndikimi negativ i këtij projekti në ekosistem. Planifikimi i shfrytëzimit të tokës, planifikohet që toka në lokacionin. betonierës të kthehet në gjendje të përafërt me ambientin rrethues, dhe të mbjellën të lashtat periodike të cilat kultivohen në rrethin të lokalitetit. Struktura përfundimtare e sipërfaqeve Pas përfundimit të punimeve në betonier me rikultivimin teknik do të krijohet një profil i ri i tokës, e cila mund të përdoret edhe për nevoja tjera. Propozohet që rikultivimi në ngastrat ku është e vendosur baza e betonit për prodhimin e betonit pos të lashtave bujqësore periodike të bahet me mbjelljen e fidanëve të ndryshme (pemëve) frytë dhënëse, pasi që sipërfaqja është e rrethuar me toka punuese mund të bëhet
------	--	--

rekultivimi me mbjelljen e kulturave bujqësore periodike. Rikultivimi teknik

Në bazë të ligjeve të mjedisit çdo tokë e dëmtuar si shkas i aktiviteteve prodhuese, pas skadimit të afatit të shfrytëzimit ekonomik të projektit, investitori është i obliguar që tokës ti kthej pamjen e më pashme. Në bazë të punimeve të kryera hartografike- pedologjike në sipërfaqet e degraduara, duhet studiuar llojet e dëmtimeve si dhe intensitetin dhe ndikimin e tyre në botën bimore e pastaj të shqyrtohen mundësit e sanimit të efekteve të pavolitshme si dhe rikultivimi i kësaj pjese. Me krijimin e sipërfaqes së lirë nga largimi i pajimeve dhe bazamenteve të betonit të bazës së betonit duhet të fillohet me dizajnimin teknik të hapësirës së lirë duke bërë përgatitjen e terenit për rikultivim teknik të sipërfaqes tokësore të degraduar. Degradimi i tokës gjatë realizimit të projektit shkon deri në at masë sa bëhet zhdukja fizike e profilit pedologjik të tokës, prandaj për këtë fazë të rikultivimit propozojmë krijimin e profilit pedologjik të tokës në sipërfaqet e dëmtuara. Për formimin e shtresës së sipërme sipërfaqësore produktive të tokës parashihet shtresimi i një shtrese të dheut prej 30 cm gjer në 50 cm.

Rikultivimi agroteknik Pas fazës së rikultivimit teknik fillon faza e rikultivimit agroteknik e cila fazë starton me analizimin e substratit të krijuar, për të përcaktuar vetitë agrokimike dhe pedologjike. Në bazë të analizave të propozohen masat meliorative dhe agroteknike që do të aplikohen në këtë tokë të re. Rikultivimi i këtyre sipërfaqeve të dëmtuara përfshin rivitalizimin në tërësi të hapësirave të dëmtuara nga veprimtaria e procesit teknologjik për prodhimin e betonit. Për të llogaritur numrin e fidaneve për tërë sipërfaqen që do të rikultivohet, duhet të kalkulohet me distancën në mes rendeve dhe distancën në rend. Në $S = a \times b$ S paraqet sipërfaqen, a- paraqet distancën në mes rendeve, b - paraqet distancën në mes fidaneve. Në rastin tonë propozojmë që të dy këto distanca të jenë nga 2 m. Në pjesët ku do të behët mbjellja e fidaneve duhet të vendoset një shtresë e humusit prej 0.3-0.5 m trashësi të analizuar nga aspekti agrokimik, pastaj duhet të bëhet ngjeshja e këtij substrati me qëllim që të jetë shtresa më kompakte. Pas këtij operacioni duhet të bëhen vrimat në mënyrë të mekanizuar. Thellësia e gropës duhet të jetë aq sa është i gjatë habitusi qendror i sistemit rrënjor të bimës, ndërsa gjerësia duhet të jetë e atillë që

		rrënjës t'i siguroj shtrirje sa më të lirë. Nëpër këto gropa duhet të hedhet 150 gr pleh mineral dhe pleh të djegur të shtallës e pastaj rreth bimës hidhet shtresa e dheut e cila duhet të jetë e ngjeshur sa më mirë. Të gjitha këto bimë duhet të kontrollohen me kujdes gjendja shëndetësore e fidaneve. Fidanet duhet të shoqërohen me ambullazh përkatëse në momentin e blerjes. Nga sistemi rrënjor hiqen të gjitha pjesët e dëmtuara. Para se të mbillen fidanet, rrënjët e tyre duhet të zhyten në solucion prej bajage të freskët dhe argjili me qëllim që kjo përzierje të shërbejë si ushqim fillestar për bimën, si dhe dheu të ngjitet sa më mirë për rrënje. Bima e përgatitur në këtë mënyrë është e gatshme për mbjellje. Koha më e përshtatshme për mbjelljen e kulturave shumëvjeçare është vjeshta. Gjatë dimrit rrënja është aktive si dhe posedon sasisë optimale të lagështisë, kështu ne pranverë bima ka një startim më të suksesshëm. Mirëmbajtjes së plantacionit të krijuar duhet kushtuar kujdes i veçantë sidomos në ujitje, prashitje, krasitje etj. Pas mbjelljes së kulturave, investitori më tutje do të kujdeset për zhvillimin e tyre. Rikultivimi biologjik Qëllimi afatgjatë i rikultivimit biologjik është që të krijojmë ekosistem të ri në hapësirat e dëmtuara në të cilën do të krijohet baraspeshë relative e të gjitha elementeve të ekosistemit siç janë: toka, flora, fauna dhe efekti ekonomik në prodhimtarin bujqësor, blegtorale dhe në silvikulturë. Rikultivimi biologjik është faza përfundimtare me të cilën arrihet edhe qëllimi i rikultivimit. Bimët të cilën e kemi propozuar në këtë projekt në sipërfaqet degraduara nga operimi i bazës së betonit janë mbjellja e fidanëve fryt dhënëse, duke e kombinuar me mbjelljen e kulturave bujqësore periodike.
--	--	--

8. MENAXHIMI I MBETURINAVE

8.1.	Përshkrimi i llojit të mbeturinave dhe klasifikimi sipas katalogut shtetëror të mbeturinave	Llojet e Mbeturinave të cilat krijohen janë: Mbeturina të ngurta komunale të cilat grumbullohen dhe vendosen në kontejnerë të posaçëm të pajisur me kapak për mbulim me qëllim të mbrojtjes së tokës dhe ujërave nëntokësor.			
		Mbeturina	Emri i mbeturinës	Shkalla e rrezikshmërisë	Lloji i deponimit
		20 01 08	Mbeturina të ngurta komunale	Jo të rrezikshme	Kontejner për mbeturina
8.2.	Përshkrimi i Magazinit apo deponimit të mbeturinave	Mbeturinat e ngurta komunale grumbullohen dhe vendosen në kontejnerë të posaçëm të pajisur me kapak për mbulim dhe merren nga kompania e pastimit. Mbeturina tjera nuk gjenerohen.			
8.3.	Përshkrimi për trajtim, përpunim dhe riciklimi të mbeturinave	Meqenëse nga ky aktivitet gjenerohen vetëm mbeturina të ngurta komunale, nuk është e nevojshme të kryhet trajtim, përpunim apo riciklim i mbeturinave në lokacion.			
8.4.	Dërgimi për trajtim dhe riciklim të operatori tjetër – kontrate me kompaninë me leje përkatëse	Kompania nuk bën dërgimin për trajtim dhe riciklim të operatori tjetër kontratë me kompaninë me leje përkatëse.			
8.5.	Plani për menaxhimin e mbeturinave	Kompania nuk ka planin për menaxhimin e mbeturinave.			
8.6.	Raportimi	Nuk bëhet raportimi			

9. RREZIKU NGA AKSIDENTET

9.1.	Plani për pengimin e aksidenteve ne rast të rrezikut/ plani i intervenimit të brendshëm dhe të jashtëm	Aksidentet të cilat mund të ndodhin, mund të jenë të natyrës së ndryshme dhe mund të ndodhin në çdo kohë gjatë realizimit të procesit teknologjik si: – Nga rrjedhjet e ndryshme të lëndëve djegëse dhe lubrifikuese. Nga mekanizmi punues. – Nga mekanizmi punues mundësia e pëlcitjes së gypave hidraulik. – Nga aksidentet e mundshme ne komunikacion gjatë transportit të agregatit, çimentos dhe betonit. – Nga aksidentet e mundshme ne komunikacion gjatë kyçjes së automjeteve transportuese nga baza e betonit në rrugën regjionale.
9.2.	Përdorimi i substancave të rrezikshme kimike dhe preparateve, planifikimi i masave për zëvendësimin e tyre	Kompania nuk posedon rezervuar për deponim të naftës dhe nuk përdor substanca të rrezikshme.
9.3.	Masat për parandalimin e aksidenteve dhe zvogëlimi i pasojave	Për parandalimin e aksidenteve dhe zvogëlimin e pasojave, kompania ka ndërmarrë këto masa: – Kryhet përdorimi, mbikëqyrja dhe mirëmbajtja e rregullt e pajisjeve dhe instalimeve, me qëllim të parandalimit të defekteve dhe uljes së rrezikut nga aksidentet. – E gjithë sipërfaqja e kompleksit është e rrethuar me tel gjembor, ndërsa në pjesët ku kërkohet mbrojtje shtesë është paraparë edhe mur statik. – Ambienti brenda kompleksit të kompanisë mirëmbahet në mënyrë të vazhdueshme, për të siguruar rend, pastërti dhe kushte të përshtatshme të sigurisë.
9.4.	Raporti mbi gjendjen e sigurisë	Kompania e ka të hartuar Raportin mbi gjendjen e sigurisë
9.5.	Plani për mbrojtjen nga zjarri	Kompania e ka të hartuar planin për mbrojtjen nga zjarri.

10. MASAT NË RASTET E PUNES JO STABILE TË IMPIANTIT

10.1.	Ndërprerja momentale e punës së impiantit	Kompania nuk ka ndërprerja momentale e punës së impiantit.
10.2.	Ndërprerja e punës	Kompania nuk ka ndërprerje të punës, përveç orarit të pushimit.

11. NDIKIMI I MUNDSHËM I NDOTJES NË SHENDETIN E NJERIUT

Kompania "Agi-Dani" Sh.p.k. Gjilan, Bazë për prodhimin e betonit në Strazhë, Novobërdë, nuk ka ndikim në shëndetin e njeriut, sepse ka ndërmarr të gjitha masat për zvogëlimin e ndotjes së ajrit, ujit, tokës dhe biodiversitetit.

Personi përgjegjës për mjedis

Rexhep Veseli

Nënshkrimi

Personi përgjegjës i kompanisë

Halit Bajraliu

Nënshkrimi
